



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

15 DEC 2022

14-050/p1-269607/22 më

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Lejohet hyrja dhe qarkullimi i mjeteve motorike dhe elektrike me qëllim të furnizimit me mallra nga Subjektet Afariste për shtatë ditë të javës, si vijon:
 1. Bulevardi/Sheshi i Kryeqytetit, nga ora 23:00 deri në 07:00 të mëngjesit - për mjetet deri në 3.5 t.
 2. Përgjatë hapësirës dhe rrugëve kryesore të Kryeqytetit, gjegjësisht Zona - 1, e cila përfshin, Rr. 'Bill Kllinton', nga udhëkryqi i rrugëve "Idriz Gjilani" dhe "Bekim Femi", bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nga rreth-rrotullimi i Flamurit, Rr. "Agim Ramadani" dhe udhëkryqi të konviktet, Rr. "Edmond Hoxha", te Salla 1 Tetori, Rr. "Ilir Konushevci" në hyrje të qytetit nga drejtimi i Podujevës, si dhe të hyrja në qendër të qytetit nga rreth-rrotullimi në lagjen Arbëria, në rrugët e "UÇK-së" dhe Rr. "Fehmi Agani", nga ora 19:00h deri në ora 07:00h, ndërsa jashtë Zonës - 1, pjesës periferike të Kryeqytetit (Zona - 2), nga ora 18:00h deri në ora 07:00h.
- II. Lejohet hyrja dhe qarkullimi i mjeteve motorike dhe elektrike si transport i veçantë (speciale dhe me rëndësi) për bartjen e mjeteve financiare dhe letrave me vlerë, në këto orare: 05:00 - 07:00, 09:00 - 11:30, 13:00 - 15:30 dhe 18:00 - 22:00.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Skica hartografike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Operativës Regjionale të Policisë, Sektorit të Operativës Policisë - NJRKRR DRP
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

